

**UNITED NATIONS**  
United Nations Interim  
Administration Mission  
in Kosovo



**NATIONS UNIES**  
Mission d'Administration  
Intérimaire des Nations  
Unies au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS**  
**СКУПШТИНА КОСОВА**  
**ASSEMBLY OF KOSOVO**

---

**Seanca plenare**

Seanca nr. 02-02/94

Prishtinë, më 22 dhjetor 2004

Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

**PROCESVERBAL**

Seancën e kryesoi Nexhat Daci, kryetar i Kuvendit të Kosovës, kurse e ndihmoi deputeti Fatmir Sejdiu.

**Kryetari** konstatoi se në seancë ishin të pranishëm 101 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kryesia ia kishte propozuar Kuvendit këtë

**R E N D D I T E:**

1. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme;
2. Betimi i deputetëve të Kuvendit;
3. Betimi i Qeverisë së Kosovës;
4. Shqyrtimi i programit të Qeverisë;
5. Formimi i komisioneve parlamentare:
  - 5.1 Miratimi i numrit të komisioneve parlamentare dhe i numrit të anëtarëve të tyre;
  - 5.2 Emërimi i kryetarëve, i nënkryetarëve dhe i anëtarëve të komisioneve parlamentare.

**Kryetari** propozoi që rendit të ditës t'i shtohet edhe një pikë – zgjedhja e zëvendësministrave. Kuvendi e miratoi propozimin e tij.

## 1. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme

Procesverbali i seancës së mëparshme u miratua pa vërejtje.

## 2. Betimi i deputetëve të Kuvendit të Kosovës

**Kryetari** kërkoi nga deputetët e Kuvendit të ngriten në këmbë dhe t'i shqiptojnë fjalët e betimit. Ai nga foltorja e lexoi tekstin e betimit, si vijon: *”Unë, deputet i Kuvendit të Kosovës, i zgjedhur me votën e lirë, sot, solemnisht betohem se me ndershmëri e me sinqeritet, me përkushtim dhe devotshmëri, me tërë qenien time, me të gjitha aftësitë e mia do të punoj në interes të Kosovës dhe të të gjithë qytetarëve, do të angazhohem në mbrojtjen dhe respektimin e kushtetushmërisë e të ligjshmërisë, në mbrojtjen e tërësisë territoriale dhe të integritetit institucional të Kosovës, në garantimin e lirive dhe të të drejtave të njeriut, në pajtim me ligjet e vendit dhe me standardet evropiane”.*

Të gjithë deputetët brohoritën:

**B e t o h e m!**

Pastaj, deputetët e pranishëm e nënshkruan fletëbetimin.

## 3. Zgjedhja e zëvendësministrave të Qeverisë së Kosovës

**Kryetari** kërkoi nga kryeministri, Ramush Haradinaj, ta paraqes para deputetëve të Kuvendit listën e zëvendësministrave.

Kryeministri Ramush Haradinaj tha: Në bazë të marrëveshjes së koalicioni qeverisës, Kuvendit i propozoj t'i zgjedh zëvendësministrat në Qeverinë e Kosovës, si vijon:

- Z. Hafiz Krasniqi, zëvendësministër në Ministrinë e Transportit dhe Telekomunikacionit
- Z. Astrit Ajeti, zëvendësministër në Ministrinë e Shëndetësisë;
- Z. Muharrem Ibrahim, zëvendësministër në Ministrinë për Ekonomi e Financa;
- Z. Fevzi Berisha, zëvendësministër në Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë;
- Z. Aziz Lila, zëvendësministër në Ministrinë e Pushtetit Lokal;
- Z. Merxhan Avdyli, zëvendësministër në Ministrinë e Mbrojtjes së Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor;
- Z. Kadri Kryeziu, zëvendësministër në Ministrinë e Tregtisë dhe të Industrisë;
- Z. Agron Dida, zëvendësministër në Ministrinë e Energjetikës dhe Minerave;
- Z. Lulzim Leci, zëvendësministër në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale;
- Z. Mark Komoni, zëvendësministër në Ministrinë e Shërbimeve Publike;
- Znj. Angelina Krasniqi, zëvendësministre në Ministrinë për Kulturë, Rini dhe Sporte;
- Z. Ibish Bajrami, zëvendësministër në Ministrinë e Kthimit dhe të Minoriteteve;
- Z. Tomë Hajdaraj, zëvendësministër në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;

- Z.Ergyn Koruglu, zëvendësministër të dytë në Ministrinë e Kulturës, Rinisë, Sporteve dhe Çështjeve Jorezidente dhe
- Z.Nazmi Fejza, zëvendësministër të dytë në Ministrinë e Kthimit dhe të Minoriteteve.

**Kryetari** e hodhi në votë propozimin e kryeministrit. Rezultati ishte si vijon:

Për-----66;  
Kundër-----1;  
Abstenime---34.

**Kryetari konstatoi:** Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash, i zgjodhi zëvendësministrat e ministrive të Qeverisë së Kosovës.

#### 4. Betimi i Qeverisë së Kosovës

**Kryetari** kërkoi nga kryeministri, Ramush Haradinaj, ta lexojë tekstin e betimit, si dhe ministrat dhe zëvendësministrat të ngriten në këmbë dhe t'i shqiptojnë fjalët e betimit.

**Kryeministri** Ramush Haradinaj, nga foltorja e lexoi tekstin e betimit të Qeverisë, si vijon: *“Ne, anëtarët e Qeverisë së Kosovës, të zgjedhur nga Kuvendi i Kosovës, betohemi solemnisht se me përgjegjësi, me përkushtim dhe me ndershmëri do t'i kryejmë të gjitha detyrat dhe punët që i kemi sipas mandatit të dhënë nga ky Kuvend, gjithmonë duke zbatuar ligjin dhe vendimet e miratuara, duke respektuar parimet, normat dhe standardet ndërkombëtare për liri, barazi, demokraci në interes të përparimit ekonomik, arsimor, kulturor e të gjithmbarshëm të popullit dhe të të gjithë qytetarëve të Kosovës”.*

Të gjithë ministrat dhe zëvendësministrat brohoritën: **B e t o h e m!**

#### 5. Shqyrtimi i Programit të Qeverisë së Kosovës

**Kryetari** e ftoi kryeministrin ta paraqiste para deputetëve të Kuvendit Programin e Qeverisë së Kosovës.

**Kryeministri** Ramush Haradinaj: Qeveria e Kosovës e ka hartuar Programin e saj për zhvillimin e Kosovës në të gjitha fushat e jetës, për një zhvillim që do të jetë i qëndrueshëm dhe në rritje të vazhdueshme. Programi në vete ka të shkrirë agjenden e standardeve për Kosovën që do të mundësojë realizimin e tyre me sukses.

Gjithashtu, ky program siguron bërjen e Kosovës shtet në proces duke mundësuar vendosjen për statusin final në përputhje me vullnetin politik të popullit të Kosovës. Në programin e Qeverisë nuk është përfshirë platforma për negociata për statusin final të Kosovës, sepse një platformë e tillë do t'i prezentohet Kuvendit të Kosovës në kohën e duhur. Planet vepruese të ministrive veç e veç sigurojnë zbatimin e këtij programi. Ky program është në përputhje me kapacitetet buxhetore të Kosovës si dhe në pajtueshmëri me synimet e përgjithshme të gjithë qytetarëve të Kosovës.

Për zbatimin me sukses të këtij programi janë inkurajuese orientimet dhe veprimet e bashkësisë ndërkombëtare për bartjen substanciale të kompetencave të rezervuara. Qeveria do të kërkojë që pushteti dhe autoriteti i institucioneve të Kosovës të shtrihet në gjithë territorin e saj.

Të vetëdijshëm për përgjegjësinë e koalicionit qeveritar, para Kuvendit dhe qytetarëve të Kosovës, propozojmë këto prioritete të veprimit:

### *1. Standardet dhe statusi*

Zbatimi i planit të standardeve do të jetë përkushtim operativ dhe ditor i Qeverisë, duke siguruar një bashkërenditje të veprimeve dhe monitorim efektiv ndërinstitucional. Do të sigurohet një bashkëpunim i ngushtë me UNMIK-un dhe institucionet etjera të Kosovës, por edhe të të gjitha organizatave në angazhimin e të gjitha instrumenteve qeveritare dhe strukturave civile të shoqërisë së Kosovës.

Qeveria do të krijojë një agjendë të saktë dhe të realizueshme që kuadri i domosdoshëm ligjor të kompletohet duke iu dhënë përparësi ligjeve që dalin nga standardet për Kosovën Bazë për përcaktimin e statusit të Kosovës do të jetë vullneti politik i popullit të Kosovës për pavarësi dhe njohja e pavarësisë së Kosovës.

### *2. Forcimi i institucioneve*

Forcimi i institucioneve është synim i parë i Qeverisë dhe këtë përmes kompletimit të Qeverisë edhe me ministrinë e nevojshme.

Në kuadër të këtij prioriteti Qeveria do të fokusohet sidomos në:

- ngritjen e kapaciteteve dhe të infrastrukturës institucionale;
- fillimin e punës për hartimin e kushtetutës së Kosovës;
- funksionimin e ekonomisë së tregut, rritjen e efektivitetit në qeverisje;
- marrjen e masave korrigjuese dhe preventive me qëllim të realizimit efektiv të objektivave;
- krijimin e parakushteve për lehtësimin e rolit monitorues dhe korrektues të UNMIK-ut në pajtim me mandatin e tij.

### *3. Ndërtimi i një administrate publike të përgjegjshme, të shtetit ligjor dhe lufta kundër korrupsionit, - do të arrihet përmes:*

- ndërtimit të një administrate që do t'i përballonte përgjegjësitë e reja edhe me rastin e transformimit të kompetencave;
- ngritjes së nivelit të organizimit, të aftësive dhe të kapaciteteve institucionale, si dhe individuale të punëtorëve të administratës publike;
- luftimit energjik të praktikave korruptive në të gjitha nivelet në shoqëri
- forcimit të sundimit të ligjit;
- përmirësimit të cilësisë së jetës së qytetarëve;
- rritjes së sigurisë së pronës, si dhe
- mbrojtjes institucionale të të drejtave të njeriut dhe të pakicave.

#### *4. Rritja ekonomike dhe punësimi*

Të gjitha potencialet e vendit dhe përkrahja ndërkombëtare duhet përqendrohen për sigurimin e një rritjeje të qëndrueshme ekonomike dhe hapjes së një perspektive për punësim produktiv.

Adresimin e barrierave për zhvillimin e bizneseve dhe tërheqjen e investimeve të jashtme nëpërmjet:

- përmirësimit të mjedisit afarist;
- korrëgjimit të politikave fiskale në favor të importit të pajisjeve dhe teknologjive të reja;
- përmirësimit të bizneseve dhe përmirësimit të politikave tregtare me fokusim në nënshkrimin e marrëveshjeve tregtare me vendet tjera;
- funksionalizimit të agjencisë për promovimin e investimeve dhe të eksportit;
- transformimit të rolit të tashëm të AKM, në një rol monitorues
- zbatimit të ligjit për financat publike;
- avancimit të procesit buxhetor dhe evitimin e dualizmit në menaxhimin e tij;
- raportimit, transparencës, eliminimit të evazionit fiskal, pengimit të aktiviteteve biznesore jolegale dhe të ekonomisë joformale.

#### *5. Arsimi, shkenca, teknologjia, rinia, kultura dhe diaspora*

Qeveria do të ndërmarrë masa për tejkalimin e vështirësive dhe të dobësive lidhur me aspektet menaxhuese të infrastrukturës dhe teknologjisë mësimore e financiare dhe vazhdimin e reformimit të arsimit në të gjitha nivelet.

Universiteti publik dhe institucionet e arsimit në Kosovë duhet të depolitizohen dhe të realizojnë më me sukses rolin e tyre të madh në zhvillimin e Kosovës.

Në kuadër të kulturës, do të mbështetet pasurimi i identitetit kulturor të qytetarëve, mbrojtja dhe restaurimi i objekteve të trashigimisë kulturore dhe kombëtare.

Në kuadër të sportit, do të realizojmë synimin për ndërkombtarizimin e sportit kosovar. Gjithashtu, duke i dhënë mbështetje sportit në Kosovë do të fokusohemi në evidencimin e parregullsive në sport dhe në gara sportive.

Në kuadër të diasporës, Qeveria do të angazhohet për mbështetjen e projekteve që kanë të bëjnë me mësimin plotësues, kulturën, ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe kombëtare për diasporën tonë.

Do të ndërmirren masa për pajisjen e diasporës me dokumente të udhëtimit dhe të shërbimeve të tjera civile, si dhe do të punohet për tërheqjen e më shumë investimeve private nga diaspora.

#### *6. Reformimi i pushtetit lokal dhe decentralizimi*

Kujdes i veçantë do të tregohet ndaj bartjes së kompetencave në drejtim të pushtetit lokal, me qëllim që pushteti t'u ofrohet të gjithë qytetarëve, veçanërisht minoriteteve, duke rritur mundësinë e veprimit të tyre institucional për qasje të barabartë në shërbime dhe për realizimin e të drejtave të tyre mbi parimet e multietnicitetit.

Programi i Qeverisë ka një qasje të veçantë për kategoritë meritore për lirinë e Kosovës. Do të kujdesemi ndaj familjeve të dëshmorëve, të invalidëve të luftës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të familjeve të martirëve dhe të të zhdukurve.

#### *7. Partneriteti dhe bashkëpunimi me bashkësinë ndërkombëtare*

Qasja e Qeverisë së Kosovës për tejkalimin e sfidave dhe krijimin e një stabiliteti demokratik, politik dhe socioekonomik bazohet në forcimin e partneritetit me komunitetin ndërkombëtar, në veçanti me: BE, SHBA, NATO, OKB-në, si dhe me organizata dhe agjenci të tjera ndërkombëtare. Ky bashkëpunim do të reflektojë siguri, stabilitet, paqe të qëndrueshme dhe fqinjësi të mirë.

Në fund, kryeministri kërkoi nga deputetët e Kuvendit ta miratonin Programin e Qeverisë. Ekspozeu i plotë i kryeministrit i është bashkangjitur transkriptit.

**Kryetari** dha pauzë pesmbëdhjetëminutshe.

Pas pauzës, kryetari e hapi diskutimin lidhur me Programin e Qeverisë së Kosovës.

**Hashim Thaçi**, në emër të PDK-së, tha se Programi i Qeverisë nuk ka substancë, i mungon vizioni, më tepër i ngjanë një punimi studimor teorik sesa programit politik e zhvillimor.

Partia Demokratike e Kosovës vlerëson se duhet të qartësohen edhe më mirë disa aspekte të Programit të Qeverisë, duke i bërë këto rekomandime:

1. Të bëhet program qeveritar angazhimi kryesor për Kosovën shtet të pavarur, sovran dhe të integruar në strukturat Veriatlantike;
2. Të specifikohen edhe më qartë dhe në mënyrë më të avancuar të drejtat e barabarta për të gjithë qytetarët;
3. Sundimi i ligjit duhet të specifikohet dhe të konkretizohet në interes të të gjithë qytetarëve;
4. Funksionimi i shërbimit civil modern dhe profesional, me status të mbrojtur me ligj;
5. Në pjesën e Programit për zhvillimin ekonomik, duhet pasur kujdes: Prioritetin e inkuadrimit të plotë të Kosovës në Evrozonë me euro si valutë; Përsheptimin e marrëveshjeve të tregtisë së lirë me vendet fqinje dhe vendet e tjera;
6. Në drejtim të mirëqenies sociale duhet të ketë asistencë sociale për qytetarët që nuk kanë mundësi t'i përmbushin nevojat elementare për veten dhe familjet e tyre.  
Në programin e Qeverisë të definohet qartë çështja e veteranëve dhe të invalidëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.
7. Kufijtë ekzistues të Kosovës të mbrohen dhe sigurohen në përputhje me parimet e së drejtës ndërkombëtare, garancionet e sigurisë nga NATO –ja, duke përfshirë dhe zhvillimin e forcës mbrojtëse të Kosovës.
8. Bashkëpunimi me shtetet fqinje, duke respektuar sovranitetin dhe integritetin territorial të njeri - tjetrit.
9. Përkrahje më kuptimplotë nga Qeveria për integrimin e të kthyerve dhe për mbrojtjen e

trashëgimisë kulturore të komuniteteve.

10. Kosova shtet i ri, që mirëpret angazhimin e vazhdueshëm të NATO-s ,të SHBA-ve, të OKB-së dhe të UE-së për garantimin e paqes dhe të sigurisë.

Diskutimi i plotë i deputetit,Hashim Thaçi, i është bashkangjitur transkriptit.

**Veton Surroi**, në emër të lëvizjes “ORA” tha se janë dy çështje që janë të avancuara në këtë program qeverisës, krahasuar me atë të mëparshmin.

Ky program është shumë më i konkretizuar dhe për këtë Qeveria meriton përgëzime.

Disa prej mungesave strukturore të këtij programi qeverisës, megjithatë mbesin.

E para, është se duhet të shpenzohet një kohë bukur të gjatë në hartimin e strategjive, posaçërisht të asaj për zhvillimin ekonomik. Dhe dy, si do të punojë në këtë kohë të ndërmjeme Qeveria në mungesë të strategjive?

Problemi i dytë, i këtij programi qeverisës është se kemi formulime të përgjysmuara lidhur me hapjen e vendeve të reja të punës, nxitjen e zhvillimit ekonomik, nxitjen e zhvillimeve të bujqësisë etj.

Mangësia më e madhe e këtij programi qeverisës është se në masë të madhe juridikisht do të jetë qeveri ose qeverisje e kontinuitetit në kuptimin juridik të fjalës.

Koncepti juridik, i propozuar në këtë program qeverisës, është koncept që vazhdon t'i mbajë dy, tri apo katër sisteme juridike, të ndryshme, brenda territorit të Kosovës.

Mangësia e tretë, nga aspekti strukturor, i këtij programi është se ekziston një shpërputhje e madhe ndërmjet përgjegjësive që ka marrë Qeveria mbi vete dhe kapacitetit intelektual apo menaxherial të disa prej ministrave të kësaj Qeverie, që nuk mund t'u përgjigjen këtyre sfidave.

Në këtë program qeverisës nuk jepen përgjigje se çfarë do të jenë masat stimulative për rritjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, për infrastrukturë, për politiken fiskale dhe atë kreditore etj.

Dhe në fund, nuk mund të flitet për luftën kundër korrupsionit nëpërmjet një agjencie.

Ai propozoi që Qeveria të formojë grupe, që do ta vlerësonin procesin e tenderimit në disa agjensi shpenzuese të buxhetit të Kosovës, për të treguar lidhur me bazueshmërinë apo jo të perceptcionit të korrupsionit në to.

Ai propozoi që Programi t'i kthehet Qeverisë për ta plotësuar, konkretizuar dhe afatizuar zbatimin e tij.

Diskutimi i plotë i deputetit, Veton Surroi, i është bashkangjitur transkriptit.

**Alush Gashi**, në emër të LDK-së, tha se janë impesive objektivat e shtruara në Programin qeveritar, realizimi i të cilave do ta bënte vendin tonë më të mirë dhe të pranueshëm.

Shkalla e zhvillimit të një vendi varet nga niveli i zhvillimit të diturisë dhe nga aplikimi korrekt i saj. Andaj edhe kërkojmë një përkushtim më të theksuar në ngritje të nivelit të gjithmbarshëm të edukimit institucional. Përkundër kufizimeve eventuale kushtetuese do ta mirëprisnim paraqitjen e vizionit e Qeverisë për strukturat e mbrojtjes dhe të sigurisë të Kosovës. Hapjen e përfaqësive të Kosovës në botë, në veçanti në UE dhe OKB, si dhe vizionin e Qeverisë për zbatimin e ligjeve të miratuara në Kuvendin e Kosovës. Mbi të gjitha do ta mirëpresim argumentimin për mundësinë e hapjes së vendeve të reja të punës. Jemi të përkushtuar të dëshmojmë se jemi shumicë e përgjegjshme. Nga Qeveria kërkojmë transparencë dhe efektivitet. Mbi këto parime, Grupi Parlamentar i LDK-së e përkrah Programin e Qeverisë së Kosovës.

**Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me Programin qeveritar, të propozuar nga kryeministri, Ramush Haradinaj, dhanë edhe këta deputetë: Jakup Krasniqi, Gjylnaze Sylja, Ylber Hysa, Mahir Jakxhillar, Sabri Hamiti, Bajram Rexhepi, Naim Maloku, Teutë Sahatxhiu, Emrush Xhemajli, Gjergj Dedaj, Behxhet Brajshori, Rifat Krasniq, Hajredin Kuçi, Numan Baliq, Fatmir Rexhepi, Enver Hoxhaj, Ramadan Kelmendi, Gazmend Muhaxheri, Lulzim Zeneli, Qibrije Hoxha, Ramë Buja, Fehmi Vula, Ibush Jonuzi, Fehmi Mujota, Fatmire Muçaku, Naser Osmani, Fadil Kryeziu, Fetah Berisha, Sevdije Halimi, Genc Gorani, Safete Hadërgjonaj, Shaban Halili, Naim Jerliu, Nazim Jashari, Bajrush Xhemajli, Gani Koci, Nexhat Rexha, Ragip Zekolli dhe Sabit Rrahmani, që i janë bashkangjitur transkriptit.**

**Kryeministri** Ramush Haradinaj iu përgjigj vërejtjeve dhe sugjerimeve të deputetëve. Kryeministri tha se këto vërejtje dhe sugjerime i konsideronte ndihmesë dhe do t'i përfshijë në Programin e Qeverisë.

Pas këtyre diskutimeve, **kryetari** e hodhi në votë Programin e Qeverisë. Rezultati ishte si vijon:

Për-----66;  
Kundër----- 1;  
Abstenime-----31.

**Kryetari konstatoi:** Kuvendi i Kosovës, më shumicë votash, e miratoi Programin e Qeverisë së Kosovës.

## **6. Formimi i komisioneve parlamentare**

### **6.1 Miratimi i numrit të komisioneve parlamentare dhe i numrit të anëtarëve të tyre**

**Kryetari** i informoi deputetët e Kuvendit për propozimin e Kryesisë që Kuvendi t'i ketë dhjetë (10) komisione të përhershme parlamentare, me nga dymbdhjetë (12) anëtare, përkatësisht trembëdhjetë (13) Komisioni për Komunitete.

**Kryetari** e hodhi në votë propozimin e Kryesisë. Rezultati ishte si vijon:



Për-----87;  
Kundër----- 2;  
Abstenime-----1.

**Kryetari konstatoi:** Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash, mori

## V E N D I M

Për formimin e dhjetë (10) komisioneve të përhershme parlamentare, Komisionit për Rregulloren e Punës së Kuvendit dhe për numrin e anëtarëve të tyre

I. Kuvendi i themelon këto komisione parlamentare:

1. Komisioni për Buxhet dhe Financa, 12 anëtarë,
2. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komunitetve dhe për Kthim, 13 anëtarë,
3. Komisioni për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese, me nënkomisionet për Barazi Gjinore, për Peticione e Ankesa Publike dhe për Personat e Pagjetur, 12 anëtarë,
4. Komisioni për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe për Integrim në UE, 12 anëtarë,
5. Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sporte, 12 anëtarë,
6. Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, 12 anëtarë,
7. Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, 12 anëtarë,
8. Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, 12 anëtarë,
9. Komisioni për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media, 12 anëtarë,
10. Komisioni për Gatishmëri dhe Emergjencë, 12 anëtarë,
11. Komisioni për Rregulloren e Punës së Kuvendit, 12 anëtarë.

### 6.2 Emërimi i kryetarëve, nënkryetarëve dhe i anëtarëve të komisioneve parlamentare

**Kryetari** i informoi deputetët e Kuvendit për propozimin e grupeve parlamentare për emërimin e kryetarëve, nënkryetarëve dhe të anëtarëve të komisioneve parlamentare.

**Jakup Krasniqi**, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, kërkoi që kryetarët e Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe të Komisionit për Ekonomi, Tregti dhe Industri të emërohen nga radhët e opozitës.

Ai kërkoi të formohej edhe një komision për çështjen e standardeve dhe të decentralizimit.

**Kryetari** tha se propozimet për emërimin e kryetarëve, të nënkryetarëve dhe të anëtarëve të komisioneve parlamentare i kanë dhënë grupet parlamentare, sipas kritereve të përcaktuara nga Kryesia e Kuvendit dhe në përputhje me numrin e deputetëve në Kuvend.

Propozimin për formimin e ndonjë komisioni ad hoc duhet ta shqyrtojë Kryesia, kurse Kuvendi mund të marrë vendim në një seancë tjetër të radhës.

Kryetari e hodhi në votë propozimin e grupeve parlamentare. Rezultati ishte si vijon:

Për-----87;  
Kundër----- 2;  
Abstenime----- 1.

**Kryetari konstatoi:** Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash, mori

## V E N D I M

Për emërimin e kryetarëve, të nënkryetarëve dhe të anëtarëve të komisioneve parlamentare:

### **1. Në Komisionin për Buxhet dhe Financa,** emërohen këta anëtarë:

1. Naser Osmani, kryetar – LDK,
2. Snezhana Miliq, nënkryetar i parë-SLKM,
3. Safete Hadërgjonaj, nënkryetare e dytë-PDK,
4. Behxhet Brajshori, anëtar – LDK,
5. Besa Gaxheri, anëtare – LDK,
6. Lutfi Zharku, anëtar – LDK,
7. Naxhije Doçi, anëtare – LDK,
8. Gani Koci, anëtar –PDK,
9. Demir Lima, anëtar – PDK,
10. Naim Maloku, anëtar – AAK,
11. Rifat Krasniq, anëtar - GP 6+,
12. Nazim Jashari, anëtar – ORA.

### **2. Në Komisionin për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim,** emërohen këta anëtarë:

1. Rangjell Nojkiq, kryetar- komuniteti serb,
2. Sanije Aliaj, nënkryetare e parë – LDK,
3. Mahir Yagcilar, nënkryetar i dytë - komuniteti turk,
4. Nait Hasani, anëtar – PDK,
5. Sllavisha Petkoviq, anëtar -komuniteti serb,
6. Nuran Mallta, anëtar- komuniteti turk,
7. Xhezair Murati, anëtar - komuniteti boshnjak,
8. Numan Baliq, anëtar - komuniteti boshnjak,
9. Sabit Rrahmani, anëtar - komuniteti ashkali,

10. Xhevdet Neziraj, anëtar - komuniteti egjiptian,
11. Bislim Hoti, anëtar - komuniteti egjiptian,
12. Zylfi Merxha, anëtar - komuniteti rom,
13. Ibishi Rustem, anëtar - komuniteti goran.

**3. Në Komisionin për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese me nënkomisionet për Barazi Gjinore, Peticione dhe Ankesa Publike dhe për Persona të Pagjetur, emërohen këta anëtarë:**

1. Hydajet Hyseni, kryetar-PDK;
2. Kolë Berisha, nënkryetar i parë – LDK;
3. Shpresa Murati, nënkryetare e dytë - GP 6+;
4. Ymer Muhaxheri, anëtar – LDK;
5. Fatmir Sejdiu, anëtar – LDK;
6. Ramadan Kelmendi, anëtar – LDK;
7. Lumniye Hyseni, anëtar – LDK;
8. Nerxhivane Dauti, anëtar – PDK;
9. Hajredin Kuçi, anëtar – PDK;
10. Gjylnaze Syla, anëtare – AAK;
11. Dragisha Krstoviq, SLKM;
12. Veton Surroi, anëtar – ORA;

**4. Në Komisionin për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Integrim në UE, emërohen këta anëtarë:**

1. Sabri Hamiti, kryetar – LDK,
2. Bajram Rexhepi, nënkryetar i parë- PDK,
3. Mahir Yagcilar, nënkryetar i dytë - GP 6+,
4. Fatmir Sejdiu, anëtar – LDK,
5. Naim Jerliu, anëtar – LDK,
6. Rudina Bukoshi, anëtare – LDK,
7. Alush Gashi, anëtar – LDK,
8. Jakup Krasniqi, anëtar – PDK,
9. Xhavit Haliti, anëtar – PDK,
10. Emrush Xhemali, anëtar - LPK – AAK,
11. Sllavisha Petkoviq, anëtar – SLKM-GIS,
12. Veton Surroi, anëtar – ORA

**5. Në Komisionin për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sporte emërohen këta anëtarë:**

1. Enver Hoxhaj, kryetar- PDK,

2. Nimon Alimusaj, nënkryetar i parë-LDK,
3. Gojko Saviq, nënkryetar i dytë-SLKM,
4. Sabri Hamiti, anëtar – LDK,
5. Gjylshene Berisha, anëtare – LDK,
6. Ragip Zekolli, anëtar – LDK,
7. Mark Krasniqi, anëtar –PSHDK- LDK,
8. Drita Statovci, anëtar – PDK,
9. Sala Ahmetaj, anëtar – PDK,
10. Myrvete Dreshaj, anëtare – AAK,
11. Nuran Mallta, anëtar - GP 6+,
12. Genc Gorani, anëtar – ORA.

**6. Në Komisionin për Ekonomi, Trgeti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion,** emërohen këta anëtarë:

1. Fatmir Rexhepi, kryetar- LDK,
2. Bajrush Xhemali, nënkryetar i parë- PDK,
3. Mahir Yagcilar, nënkryetar i dytë- GP 6+,
4. Ibush Jonuzi, anëtar – LDK,
5. Brikenda Kryeziu, anëtare – LDK,
6. Milazim Haliti, anëtar – LDK,
7. Fadil Gashi, anëtar – LDK,
8. Sala Berisha –Shala, anëtare – PDK,
9. Hatixhe Hoxha, anëtare – PDK,
10. Xhevdet Neziraj, anëtar - IRDK- AAK,
11. Sllagjan Iliq, anëtar – SLKM,
12. Teuta Sahatqija, anëtare – ORA.

**7. Në Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor,** emërohen këta anëtarë:

1. Rifat Krasniq, kryetar-GP 6+,
2. Lulzim Zeneli, nënkryetar i parë – LDK,
3. Goran Bogdanoviq, nënkryetar i dytë-SLKM,
4. Isuf Sutaj, anëtar – LDK,
5. Shaban Halimi, anëtar – LDK,
6. Zyhrije Maloku, anëtare – LDK,
7. Fetah Berisha, anëtar – LDK,
8. Berat Luzha, anëtar – PDK,
9. Afrim Arzualxhiu, anëtar – PDK,
10. Xhelal Canziba, anëtar – PDK,
11. Sylejman Çerkezi, anëtar – PD-AAK,
12. Nazim Jashari, anëtar – ORA.

**8. Në Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale ,** emërohen këta anëtarë:

1. Fatmire Mulhaxha-Kollçaku, kryetare – ORA,
2. Naim Jerliu, nënkryetar i parë-LDK,
3. Shpresa Murati, nënkryetare e dytë- GP 6+,
4. Ilaz Pireva, anëtar – LDK,
5. Nurishahe Hulaj, anëtare – LDK,
6. Nafije Berisha, anëtare – LDK,
7. Fehmi Vula, anëtar – LDK,
8. Flora Brovina, anëtar – PDK,
9. Teuta Hadri, anëtar – PDK,
10. Zahrije Jusufi, anëtar – PDK,
11. Zylfije Hundozi, anëtare – AAK,
12. Zllatica Kujunxhiq, anëtare – SLKM-GIS

**9. Në Komisionin për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media,** emërohen këta anëtarë:

1. Nekibe Kelmendi, kryetare – LDK,
2. Fehmi Mujota, nënkryetar i parë-PDK,
3. Oliver Ivanoviq, nënkryetar i dytë-SLKM,
4. Ramadan Musliu, anëtar – LDK,
5. Nexhat Rexha, anëtar – LDK,
6. Kamber Kamberi, anëtar – LDK,
7. Jonuz Kastrati, anëtar – LDK,
8. Hajredin Hyseni, anëtar – PDK,
9. Selvije Halimi, anëtar - PDK
10. Myrvete Dreshaj, anëtare – AAK,
11. Shpresa Murati, anëtare - GP 6+,
12. Ylber Hysa, anëtar – ORA.

**10. Në Komisionin për Gatishmëri dhe Emergjencë,** emërohen këta anëtarë:

1. Naim Maloku, kryetar – AAK,
2. Ylber Hysa, nënkryetar i parë-ORA,
3. Xhezair Murati, nënkryetar i dytë-GP 6+,
4. Agim Krasniqi, anëtar –LDK,
5. Fadil Geci, anëtar – LDK,
6. Samije Zeqiraj, anëtare – LDK,
7. Fadil Kryeziu, anëtar – LDK,
8. Qibrije Hoxha, anëtare – LDK,
9. Sokol Bashota, anëtar – PDK,
10. Emin Krasniqi, anëtar – PDK,
11. Arsim Bajrami, anëtar – PDK,
12. Vesna Jovanoviq, anëtare – SLKM

**11. Në Komisionin për Rregulloren e Punës së Kuvendit,** emërohen këta anëtarë:

1. Hajredin Kuçi, kryetar – PDK,
2. Bislim Hoti, nënkryetar i parë - IRDK- AAK,
3. \_\_\_\_\_, nënkryetar i dytë-SLKM,
4. Kolë Berisha, anëtar – LDK,
5. Nekibe Kelmendi, anëtare – LDK,
6. Fatmir Sejdiu, anëtar – LDK,
7. Ramadan Kelmendi, anëtar – LDK,
8. Naim Jerliu, anëtar – LDK,
9. Gani Koci, anëtar – PDK,
10. Hydajet Hyseni, anëtar – PDK,
11. Mahir Yagcilar, anëtar - GP 6+,
12. Nazim Jashari, anëtar – ORA.

Nënkryetar i dytë i këtij komisioni, nga radhët e SLKM-së, emërohet në seancën e radhës.

**Kryetari** e deklaroi seancën të mbyllur në orën 16:35 minuta.

Përgatitur nga

**Spektori për Çështje Plenare dhe Procedurale**

Kryetari i Kuvendit të Kosovës  
Akademik **Nexhat DACI**

---